

BASHKIA KORÇE
NR 8071
PROT
DATA 15.08 /2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

KORÇË MË ____/____/2025

RELACION

PER

PROJEKT VENDIMIN

“Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademi e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”

Të nderuar Këshilltarë !

I. Qëllimi i projekt vendimit dhe objektivat që synohen të arrihen

Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ka përcaktuar funksionet e NJVV-ve dhe të drejtën dhe detyrimin për trajnimin e zyrtarëve (punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë) në mënyrë që ato të ushtrojnë këto funksione sipas ligjit, standarteve, me efektivitet, efikasitet dhe në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare, si dhe me standardet e BE-së. Në ligj parashikohet trajnim sistematik dhe buxhetor i stafit të NJVV-ve. Në këtë kuadër, kryetari i bashkisë duhet të marrë masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive (Neni 64/h), ndërkohë këshilltarët kanë të drejtën e formimit profesional, sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak (Neni 51/4).

Ky projekt vendim ka si qëllim mundësimin e zhvillimit dhe kualifikimit profesional të qendrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të bashkisë.

Ky projekt vendim ka si objektiva:

- Krijimin e mundësive për ushtimin e përgjegjësive ligjore të këshillit bashkiak dhe të kryetarit të bashkisë për zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të këshillit të qarkut.
- Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030.
- Zbatimin e Dokumentit Kombëtar të Politikave dhe të Strategjisë për Administratën Publike.
- Aftësimin e zyrtarëve të bashkisë për të përballuar sfidat dhe kërkesat e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Krijimi i një strukture të dedikuar për aftësimin, kualifikimin profesional dhe trajnimin e zyrtarëve të bashkisë.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta (SPK) në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 pika 5. Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Palët përcaktojnë ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave të SKP.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

II. Vlerësimi i projekt aktit në raport me politikat dhe prioritet e bashkisë dhe të Qeverisë së Shqipërisë.

Vetëqeverisja vendore është shtyllë themelore e funksionimit të një shoqërie demokratike dhe e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, dhe garanton qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër me qytetarët. Suksesi i procesit të decentralizimit dhe i ushtrimit të autonomisë vendore varet, ndër të tjera, edhe nga cilësia e hartimit, zbatimit dhe moniorimit të politikave të bashkisë, cilësia e shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe aftësia e bashkisë për t'ju përgjigjur cilësisht nevojave dhe tendencave zhvillimore në nivel vendor, varen në një masë të madhe nga njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe profesionalizimi i të zgjedhurive vendorë, i nëpunësve publikë të administratës së bashkisë si dhe i punonjësve të institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve në varësi të bashkisë.

Vetëqeverisja vendore në Shqipëri përballlet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të burimeve, hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve dhe komuniteteve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Procesi i decentralizimit të funksioneve tek bashkitë si dhe rritja e kërkesave për shërbime nga qytetarët dhe komunitetet e bëjnë të domosdoshme rifreskimin, përmirësimin dhe avancimin e njohurive dhe aftësive të zyrtarëve vendorë. Gjithashtu edhe politikat kombëtare për të modernizuar administratën publike si dhe për të digjitalizuar qeverisjen dhe shërbimet administrative, bëjnë të domosdoshme kualifikimin, profesionalizimin dhe modernizimin e administratës publike të NJVV-ve.

Trajnimet për zyrtarët e NJVV-ve janë ofruar nga subjekte të ndryshme shtetërore dhe në një masë të madhe nga programet e huaja të asistencës teknike, por këto trajnime kanë qenë sporadike, nuk kanë qenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat konkrete të NJVV-ve. Trajnimet nuk janë ofruar për të gjitha funksionet e NJVV-ve, dhe për më tepër kanë lënë shpesh jashtë vëmendjes të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jo-nëpunës civil të NJVV-ve. Trajnimet janë fokusuar kryesisht në përmbushjen e nevojave të përgjithshme horizontale, duke mos adresuar në mënyrë të gjerë dhe të thelluar temat vertikale që lidhen me funksionet dhe shërbimet specifike sektoriale të qeverisjes vendore. Për më tepër, nuk ka ekzistuar ndonjë proces i institucionalizuar dhe i rregullt konsultimi me zyrtarët e NJVV-ve për identifikimin e nevojave për trajnime apo për përmbajtjen e kurrikulave të trajnimit, veçanërisht ato sektoriale.

ASPAs dhe institucione të tjera shtetërore kanë ofruar një grup shërbimesh trajnimi për NJVV-të sipas parashikimeve ligjore, por ato mbeten të pamjaftueshme përkundrejt sfidave që NJVV-të përballen dhe pritet që të përballen në kuadër të procesit të integritetit në BE.

Për pasojë, NJVV-të nuk kanë arritur të plotësojnë nevojat specifike të punonjësve të tyre, duke krijuar një hendek të madh në përmbushjen e kërkesave për trajnim dhe kjo ka sjell në pah nevojën për një qasje më strategjike dhe të integruar dhe një strukturë të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve dhe kualifikimin profesional të zyrtarëve të NJVV-ve, në mënyrë që ato të përmbushin kërkesat në rritje për shërbime cilësore të vetëqeverisjes vendore.

Numri i zyrtarëve të NJVV-ve ka ardhur në rritje, nga rreth 21,442 (2015), në rreth 32,000 (2021), 37,518 (2022), dhe rreth 39,000 (2023), ku të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jashtë shërbimit civil përbëjnë shumicën e zyrtarëve të NJVV-ve, rreth 85% (*White Paper për Akademinë-2024*). Pavarësisht rritjes së numrit të zyrtarëve të NJVV-ve, mbështetja financiare e NJVV-ve për trajnimet e tyre mbetet e ulët.

Por ndërkohë që numri i zyrtarëve të NJVV-ve dhe nevoja e tyre për trajnim ka ardhur në rritje, asnjë strukturë nuk ka pasur mandatin apo kapacitetin për të trajnuar në mënyrë të plotë, praktike dhe në kohën e duhur të zgjedhurit vendorë, nëpunësit civil dhe punonjësit e institucioneve e ndërmarrjeve në varësinë e NJVV-ve.

III. Koncepti, procesi, aktorët dhe modalitetet për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjen Vendore.

Ngritja e Akademisë për Qeverisjen Vendore, si një strukturë të dedikuar për trajnim e zyrtarëve të NJVV-ve, përfaqëson realizimin e një nisme të kahershme dhe një kërkesë të artikuluar e lobuar prej vitesh nga NJVV-të, me synimin për të përmbushur nevojat e mëdha dhe në rritje për aftësimin dhe kualifikimin e të gjithë zyrtarëve të tyre.

Vizioni për të ngritur një strukturë të dedikuar për trajnimin e zyrtarëve të NJVV-ve u materializua në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimi dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 miratuar me VKM nr. 252, datë 20.4.2023, dhe u mbështet nga grupi ndër-institucional të punës të ngritur me urdhër të Kryeministrit (Janar 2023), dhe në takimet e të cilit morën pjesë morën pjesë aktive edhe shoqatat e NJVV-ve. Procesi i diznjimit të Akademisë u mbështet me ekspertizë të huaj dhe vendase, të financuar nga Qeveria Svicerane dhe Qeveria Suedeze, u realizua në konsultim me kryetarë të bashkive dhe të këshillave bashkiakë të spektrit të ndryshëm politik si dhe me kryetarë të këshillave të qarqeve. Procesi i diznjimit të Akademisë u realizua me përfshirjen e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë dhe me praninë e zyrës së Komisionit Evropian në Tiranë dhe të donatorëve të tjerë. Për diznjimin e Akademisë u morën parasysh 10 modele të shkollave dhe qendrave të trajnimit për administratën publike në Evropë dhe në rajon, si dhe modele të qendrave të trajnimit në Shqipëri. Ndërkohë, me shkresën nr. 532 prot., datë 18.09.2024 Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ju drejtua 61 kryetarëve të bashkive, duke kërkuar konfirmimin për përfshirjen në buxhetin e vitit 2025 të kontributit financiar të secilës bashki për të mbështetur trajnimet e zyrtarëve të tyre përmes një strukture të dedikura dhe në bazë të numrit të punonjësve të tyre.

Nga ana e NJVV-ve dhe në funksion të realizimit të iniciativës për ngritjen e Akademisë, Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Bashkive, me vendimin e saj të datës 04.09.2024, dakortësoi angazhimin e

bashkive të Shqipërisë për mbështetjen e kësaj iniciative, si dhe për bashkëfinancimin e Akademisë në vlerën 50% të shpenzimeve operacionale dhe të trajnimeve.

Në vijim të këtyre iniciativave, Grupi Ndër-institucional i Punës miratoi Dokumentin e Politikës (White Paper) për Akademinë (Shtator 2024), dokument që më pas u miratua nga Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeveri Vendore (Dhjetor 2024).

Në përgjigje të angazhimit të Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur ngritjen e Akademisë si dhe të mbështetjes së shoqatave të NJVV-ve për ngritjen e Akademisë, këshillat bashkiakë konfirmuan njëzëri mbështetjen e tyre për nevojën e ngritjes së Akademisë, përmes miratimit të një fondi për trajnimet e zyrtarëve të bashkisë e që do t'i vihej në dispozicion Akademisë në momentin e regjistrimit të saj. Ky angazhim financiar përbën një shprehje e vullnetit të fortë të bashkive për ngritjen dhe financimin e Akademisë, si dhe përbën një element të rëndësishëm për avancimin e procesit të ngritjes së subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP).

Edhe Këshilli Bashkiak Korçë me Vendimin Nr 176, Datë 26.12.2024 “ Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 si dhe të PBA 2025–2027 të Bashkisë Korçë ”, miratoi fondin që do i vihej në dispozicion Akademisë.

Akademia që propozohet të ngrihet si personi juridik subjekt i kompetencave të përbashkëta, do të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh për të mbështetur dhe përmirësuar kapacitetet e NJVV-ve në Shqipëri duke përfshirë hartimin e kurrikulave dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara, administrimin e platformës për menaxhimin dhe ndarjen e njohurive mes zyrtarëve të NJVV-ve, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes tyre, ofrimi i ekspertizës dhe shërbimeve të konsulencës ndaj NJVV-të për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e objektivave në lidhje me zhvillimin e burimeve të tyre njerëzore.

Ngritja e Akademisë është thelbësore për t'i mundësuar NJVV-ve përballimin e sfidave për rritjen e cilësisë së jetës, zhvillim të qëndrueshëm të territorit dhe komuniteteve vendore si dhe sfidave që po sjell procesi i integritetit të Shqipërisë në BE. Vlerësohet se 70% e *acquis* zbatohet nga qeveritë vendore dhe rajonale dhe NJVV-të do të kenë një rol të rëndësishëm në këtë proces, dhe kjo është arsyeja pse niveli i njohurive dhe aftësive të zyrtarëve të NJVV-ve, për të përballuar këto procese, merr një rëndësi të veçantë.

Synohet që ofrimi i trajnimeve të përfshijnë tema specifike dhe sektoriale “vertikale” që lidhen me funksionet e NJVV-ve dhe me rreth 41 shërbimet e vetëqeverisjes vendore të tilla si Zhvillimi i Territorit, Infrastruktura dhe Shërbimet Publike, Shërbimet Sociale; Mbrojtja e Mjedisit; Bujqësia; Zhvillimi Rural; Pyjet dhe Kullotat Publike; Zhvillimi Ekonomik Vendor, Siguria Publike, etj. Programet e trajnimit do të hartohen bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, do të jenë paktike dhe dinamike, ndërkohë që hartimi i kurrikulave dhe dhënja e trajnimeve do të koordinohet me ASPA për të evituar mbivendosje të trajnimeve të ofruara.

Përfituesit kryesorë të shërbimeve janë nëpunësit civilë dhe punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të NJVV-ve, si dhe të zgjedhurit vendorë, që përbëjnë rreth 39,000 persona. Kjo përfshirje e gjerë ndihmon në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 (5). Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përmbushjen e objektivave.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizatë Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve”, ndryshuar. Ky opsion ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

Stategjia decentralizimit

Themelimi i OJF-së si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis qeverisjes qendrore dhe NJVV-ve, përmes aktit themelues dhe statutit, kërkon në të njëjtën kohë miratimin nga të gjithë këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve të marrëveshjes për anëtarësimin në Akademi, SKP në formë OJF-je, si dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje nga ministri përgjegjës për çështjet vendore sipas autorizimit të dhënë nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përmes VKM 405 dt.16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me

njesite e vetëqeverisjes vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të republikës së shqipërisë". Sipas këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka marrë angazhimin të mbështesë financiarisht Akademinë përmes mbulimit të kostove fillestare të themelimit të saj si subjekt i kompetencave të përbashkëta, si dhe të financojë jo më pak se 50% të kostove operacionale të funksionimit të Akademisë për tri vitet e para të funksionimit për përmbushjen e objektivave të saj.

Hapi vijues në këtë proces është miratimi i marrëveshjes nga këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar. Pas përfundimit të këtij procesi të miratimit, do të vijohet me regjistrimin e personit juridik në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8788/2001, "Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve", të ndryshuar.

IV. Propozimi për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja "b" dhe nën-pika 1.6, shkronja "b", nenit 14 pika 5, nenit 54, shkronja "d" dhe "gj", nenit 55, pikat 3, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore", Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", i propozojmë Këshillit Bashkiak si më poshtë vijon:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi, të quajtur "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)".

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësisht komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e

zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulence ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin e emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Korçë në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Korçë si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përlllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillit të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkëthës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë, të nënshkruajë marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”* dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA--s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë të përfaqësojë Bashkinë Korçë në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Korçë nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA-s.

**Drejtores e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe
e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Anxhela Qeramixhi (Dishnica)**

**KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq FILO**

AKT THEMELIMI

“AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Themeluesit e Akademisë së Trainimit të Njesive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA) janë:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri përgjegjës për çështjet vendore me seli në _____, Tiranë; dhe

Bashkia Korçë, Bashkia _____, Bashkia _____, Bashkia _____,

Këshilli i Qarkut _____, Këshilli i Qarkut _____,

Kjo shoqatë është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të anëtareve të saj themelues, pa asnjë qëllim fitimi, joqeveritarë dhe e pavarur.

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Krijimi dhe forma

1. Akademia e Trajnimit të Njesive të Vetëqeverisjes Vendore të të Republikës së Shqipërisë është një subjekt i ndarë nga palëve themeluese të cilat janë Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe si Bashkitë dhe Qarqet e Republikës së Shqipërisë.
2. Akademia është person juridik, organizatë jofitimprurëse, subjekt i kompetencave të përbëshkëta i anëtarëve nënshkrues të këtij akti themelimit dhe të këtij Statuti, që krijohet, organizohet dhe funksionon sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kryesisht të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Akademia fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në bazë të Ligjit nr. 80, datë 24.6.2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

Neni 2 Personaliteti juridik

1. Akademia fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në bazë të legjislacionit në fuqi, dhe konkretisht të Ligjit nr. 80, datë 24.6.2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (i ndryshuar).
2. Personaliteti juridik i Akademisë mbaron në ditën kur vendimi i gjykatës për çregjistrimin e saj merr formë të prerë.

Neni 3

Emërtimi

1. Emri zyrtar i Shoqatës është “*Akademia e Trajnimit të Qeverisjes Vendore të Shqipërisë*”.
2. Përkthimi zyrtar në gjuhën Angleze i emrit të Shoqatës është “*Training Academy for Local Government of Albania*”.
3. Emri zyrtar i shkurtuar i Shoqatës është “TALGA”.
4. Selia e “TALGA”-s është në Tiranë në adresën: “*Rruga _____, Tiranë*”. TALGA mund të hapë degë/filiale të saj, brenda Republikës së Shqipërisë, duke ruajtur misionin dhe qëllimin e saj të veprimtarisë.
5. TALGA ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të pakufizuar kohore.
6. TALGA gëzon pavarësi vendimmarrëse, administrative, akademike, financiare e teknike.
7. TALGA krijon dhe menaxhon numrin e llogarisë bankare të saj dhe numrin fiskal të identifikimit.

Neni 4

Kohëzgjatja

TALGA themelohet pa afat.

Neni 5

Misioni dhe parimet kryesore

1. Misioni i TALGA-s është aftësimi cilësor, i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të NJVV-ve, si dhe trajnimin e personave të tjerë të interesuar në sektorin e vetëqeverisjes vendore, përmes zhvillimit dhe kualifikimit të tyre profesional, administrimit të programeve të trajnimit dhe programeve të tjera të zhvillimit të vazhdueshëm e profesional. TALGA bazuar në kërkesat dhe nevojat e vlerësuara prej saj, ofron vetë ose përmes partnerëve të saj, trajnime sektoriale dhe të specializuara në nivel kombëtar ose rajonal, mundësi për rrjetëzim dhe shkëmbime njohurish, si dhe mësimnxënie përmes një sistemi të menaxhimit dhe shpërndarjes së njohurive, si dhe praktikave të mira.
2. TALGA nxit qeverisjen e mirë vendore, shkëmbimin e njohurive, ndarjen e praktikave më të mira, nxit inovacionin në vetëqeverisjen dhe administrimin vendor dhe mbështet fuqizimin dhe përparimin e qëndrueshëm të NJVV-ve, duke ndihmuar që ato të rrisin kapacitetet për

hartimin e politikave për zhvillim të qëndrueshëm, bashkëkohor dhe përfshirës, ofrimin e shërbimeve cilësore për komunitetet vendore, si dhe përmbushjen me sukses të sfidave që lidhen me procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

3. TALGA ndihmon organet dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore të adresojnë sfidat e tyre më kritike të qeverisjes dhe menaxhimit, përmes studimeve dhe analizave, shërbimeve këshillimore dhe asistencës teknike, si dhe pjesëmarrjes në forume, konferenca dhe aktivitete të tjera të ndarjes së eksperiencave.
4. Në realizimin e qëllimit dhe të objektivave të përcaktuara në këtë Statut, TALGA, në çdo kohë, siguron pajtueshmërinë e plotë me parimet e organizimit dhe funksionimit si një organizatë e pavarur dhe jo partizane, organizim mbi bazën e vullnetarizmit, barazisë mes anëtarëve të saj, si dhe solidaritetit dhe respektit për diversitetet dhe pavarësi.
5. TALGA është ndërmjetësuese e besueshme institucionale me autoritetet e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore, pavarësisht orientimit politik, dhe është një partnere e besueshme për bashkëpunëtorët e tjerë vendas dhe ato ndërkombëtarë.
6. TALGA kryen veprimtari të tjera që lejohen nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Qëllimi i TALGA-s

Qëllimi i TALGA-s është:

- a) Promovimi i vlerave, etikës, standardeve dhe besimit në shërbimin publik të ofruar nga NJVV-të, si dhe i qeverisjes së mirë dhe demokracisë vendore.
- b) Rritja e cilësisë së administratës publike të NJVV-ve, për t'i shërbyer mirëqenies në rritje dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve vendore, mbrojtjes dhe zhvillimit të territorit dhe mjedisit, si dhe përmbushjes me sukses nga NJVV-të të kërkesave të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- c) Aftësimi i të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të NJVV-ve, për të rritur performancën e vetëqeverisjes vendore përmes rritjes së cilësisë së hartimit dhe zbatimit të politikave publike efektive në nivel vendor.
- ç) Promovimi i të mësuarit përgjatë gjithë jetës për zyrtarët vendorë dhe të risive në vetëqeverisjen vendore.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 7

Organi vendimmarrës

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i TALGA-s.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga kryetarët e bashkive dhe kryetarët e këshillave të qarqeve, anëtarë të TALGA-s, si dhe ministri përgjegjës për çështjet vendore si përfaqësues i Këshillit të Ministrave.

3. Si rregull, mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohen një herë në vit. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme bëhet me kërkesë të Kryetarit të saj, me vendim të Komitetit Drejtues, me kërkesën e të paktën 1/3 e anëtarëve të Komitetit Drejtues ose me kërkesë të 1/4 të anëtarëve të saj.
4. Asambleja e Përgjithshme mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të saj.

Neni 8

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
 - a) Miraton vizionin, drejtimit strategjike dhe deklaratat e politikave të TALGA-s;
 - b) Shqyrton dhe miraton ndryshimet në statutin e TALGA-s;
 - c) Miraton burimet financiare dhe masën e kuotës së anëtarësisë së TALGA-s;
 - ç) Miraton aktet më të rëndësishme për buxhetin e TALGA-s;
 - d) Miraton planin vjetor të punës së TALGA-s, raportin vjetor të veprimtarive dhe raportin vjetor financiar për kohën mes dy Asambleve;
 - dh) Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe strukturës së TALGA-s;
 - e) Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht veprimtarinë e TALGA-s;
 - ë) Emëron, liron dhe shkarkon anëtarët dhe drejtuesit e Komiteti Drejtues të TALGA-s;
 - f) Vendors për pranimin apo përjashtimin e një anëtari të TALGA-s për arsytet e parashikuara në këtë Statut;
 - g) Miraton Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Asamblesë;
 - gj) Miraton krijimin e subjekteve të veçanta për zhvillimin e veprimtarive ekonomike të TALGA-s, me kusht që veprimtaria e këtyre subjekteve të jetë në përputhje me misionin, qëllimet dhe objektivat e TALGA-s;
 - h) Vendors për likuidimin, bashkimin apo ndarjen e TALGA-s;
 - i) Vendors për shpërndarjen e TALGA-s;
 - j) Vendors edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në këtë statut.

Neni 9

Komiteti Drejtues

1. Komiteti Drejtues i TALGA-s është organi ekzekutiv më i lartë që drejton veprimtarinë e TALGA-s dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët. Komiteti Drejtues është përgjegjës për zbatimin e drejtimeve strategjike dhe politikave dhe programeve të miratuara nga Asambleja e TALGA-s, për shpërndarjen e burimeve financiare, njerëzore dhe materiale, si dhe për mbikëqyrjen e funksionimit dhe veprimtarive të administratës së TALGA-s.

2. Komiteti Drejtues përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, nga të cilët pesë janë përfaqësues të Institucioneve të Qeverisë Qendrore dhe pesë të NJVV-ve, dhe anëtari i njëmbëdhjetë do është përfaqësues i Universitetit të Tiranës.
3. Përbërja e Këshillit Drejtues është si më poshtë:
 - Ministri përgjegjës për çështjet vendore, – Kryetar;
Anëtarë:
 - Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
 - Përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike;
 - Përfaqësuesi i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA);
 - Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave;
 - Kryetar Bashkie, përfaqësues i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, që përket shumicës qeverisëse në nivel vendor, sipas rezultatit të zgjedhjeve më të fundit për NJVV-të;
 - Kryetar bashkie, përfaqësues i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, që i përket opozitës qeverisëse në nivel vendor, që ka numrin më të madh të kryetarëve të bashkive, sipas rezultatit të zgjedhjeve më të fundit për NJVV-të;
 - Kryetar i Këshillit të Qarku, përfaqësuesi i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë;
 - Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë;
 - Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve;
 - Përfaqësuesi i Universitetit të Tiranës.
4. Komiteti Drejtues zgjedh përkatësisht përfaqësuesin e Këshillit të Qarkut të Tiranës dhe një kryetar bashkie, në detyrën e zëvendëskryetarëve të Komitetit Drejtues. Zëvendëskryetari drejton punimet e Komitetit Drejtues në mungesë ose me porosi të Kryetarit dhe kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga kryetari i Komitetit Drejtues, në përputhje me parashikimet e bëra në këtë statut.

Neni 10

Kompetencat e Komitetit Drejtues

Komiteti Drejtues ushtron këto kompetenca:

- a) Drejton veprimtarinë e TALGA-s gjatë periudhës midis dy Asambleve të Përgjithshme.
- b) Miraton strategjitë e veprimit në përputhje me drejtimet strategjike të miratuara nga Asambleja, miraton Planin Strategjik dhe planet e tjera operationale të TALGA-s, si dhe miraton planin vjetor të punës së Komitetit Drejtues;
- c) Miraton raportin e nevojave për trajnim, programet e trajnimit, si dhe planet vjetore të trajnimeve për të zgjedhurit dhe punonjësit e NJVV-ve, pasi ka marrë më parë pëlqimin paraprak të ASPA, me qëllim shmangien e mbivendosjeve për programet e trajnimit përkatëse që zhvillohen nga ASPA.
- ç) Miraton buxhetin vjetor, sipas orientimeve buxhetore dhe financiare të miratuara nga Asambleja, vendos për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe monitoron menaxhimin e financave dhe fondeve nga administrata e TALGA-s;

- d) Shqyrton, merr vendim dhe i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin financiar dhe të veprimtarive për periudhën mes dy asambleve.
- dh) Diskuton dhe miraton propozimet për ndryshimet e Statutit të TALGA-s.
- e) I propozon Asamblesë së Përgjithshme masën e kuotës së anëtarësisë, vendim të cilin e merr me votim “Pro” të jo më pak se 3/5 të të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues.
- ë) Miraton propozimin për rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me dokumentat e çështjeve për shqyrtim, dhe ia paraqet Asamblesë për shqyrtim dhe miratim;
- f) Miraton organikën dhe strukturën organizative të TALGA-s, sipas normave për organizimin dhe strukturimin e TALGA-s të miratuara nga Asambleja, si dhe miraton kriteret, rregullat dhe procedurat e aplikimit dhe të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të lartë drejtues të TALGA-s;
- g) Miraton rregulloren e brendshme të Komitetit Drejtues;
- gj) Shqyrton, merr vendim dhe i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme propozimin për marrjen e kredive;
- h) Miraton llojet e shërbimeve dhe veprimtarive ekonomike të TALGA-s dhe tarifat përkatëse;
- i) Miraton nivelin e pagave të administratës së TALGA-s si dhe shpërblimin e trajnerëve, bazuar në aktet e rëndësishme për buxhetin e TALGA-s të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- j) Bën vlerësimin e performancës së TALGA dhe ndikimit të programeve të saj në përmirësimin e vetëqeverisjes vendore, si dhe të performancës së Drejtorit Ekzekutiv të TALGA;
- k) Mbikëqyr zbatimin e standardeve për çertifikimin dhe akreditimin e programeve të trajnimit, dhënien e trajnimeve dhe të trajnerëve.
- l) Propozon pranimin apo largimin nga TALGA të një NJVV-je anëtare, dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- ll) Emëron, liron ose shkarkon nga detyra Drejtorin Ekzekutiv të TALGA-s kur votojnë “Pro” jo më pak se 3/5 e të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues.
- m) I propozon Asamblesë krijimin dhe fushat e veprimtarisë së komisioneve teknike ose këshillimore në ndihmesë dhe mbështje të veprimtarisë së Komitetit Drejtues;
- n) Miraton propozimet për blerjen, shitjen, transferimin dhe dhënien me qira të pasurive të TALGA-s.
- nj) Shqyrton dhe merr vendime për çështje për të cilat është ngarkuar nga Asambleja e Përgjithshme;
- o) Vendosi për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- p) Emëron likuidatorin/likuidatorët në rast të shpërndarjes së TALGA.

- q) Vendos për çështje të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë statut, në lidhje me veprimtarinë e TALGA-s, dhe që nuk janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme e shprehur në këtë statut.

Neni 11

Drejtori Ekzekutiv i TALGA-s

1. Drejtori ekzekutiv është punonjësi më i lartë ekzekutiv i administratës së TALGA-s dhe përfaqësuesi ligjor për administrimin e TALGA.
2. Drejtori ushtron kompetencat dhe detyrat sipas këtij Statuti dhe akteve të tjera të TALGA-s në përputhje me politikat, planet dhe aktet dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues
3. Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca:
 - a) Drejton veprimtarinë administrative të TALGA-s në zbatim të misionit dhe funksioneve të përcaktuara në statutin e TALGA, si dhe të politikave, strategjive, planeve të punës për realizimin e programeve, projekteve dhe zbatimin e buxhetit dhe vendimeve të tjera të Komitetit Drejtues të TALGA-s;
 - b) Harton projekt planin strategjik, planet operationale, rregulloret e punës së TALGA-s, akt-marreveshjet, model kontratat, raportet e Komitetit Drejtues për Asamblenë e TALGA-s.
 - c) Harton projekt buxhetin vjetor dhe afatmesëm dhe është përgjegjës për zbatimin e tij.
 - ç) Përgatit dhe paraqet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues raportet e aktiviteteve dhe ato financiare të TALGA-s.
 - d) Raporton para Komitetit Drejtues, jo më pak se tre herë në vit, për shpenzimet e buxhetit dhe për aktivitetet e kryera;
 - dh) I propozon Komitetit Drejtues projekt organikën dhe strukturën organizative, përshkrimet e punës për pozicionet e larta në administratën e TALGA-s, si dhe kriteret, rregullat dhe procedurat e aplikimit dhe të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të tjetër të TALGA.
 - e) Menaxhon punonjësit e TALGA-s, kujdeset për kushtet e punës së tyre, si dhe është përfaqësuesi ligjor i TALGA në marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj.
 - ë) Rekruton stafin e TALGA-s sipas sipas kriterëve, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të TALGA-s të miratuar nga Komiteti Drejtues.
 - f) Harton, nënshkruan, lidh dhe zgjidh kontratat e punës me stafin e TALGA duke iu referuar legjislacionit në fuqi, rregullores së brendshme të TALGA-s dhe përshkrimit të punëve të miratuara nga Komiteti Drejtues të TALGA-s, si dhe mundëson zhvillimin e tyre profesional.
 - g) Siguron mbarëvajtjen financiare të TALGA bazuar në politikat dhe rregulloret e menaxhimit financiar të miratuara nga Komiteti Drejtues.

- gj) Mbikqyr veprimtarinë e TALGA, mbledhjen dhe shpenzimet e burimeve financiare si dhe ekzekutimin e marrëveshjeve dhe kontratave.
- h) Organizon dhe përgatit mbledhjet e organeve të TALGA-s.
- i) Bashkëpunon me agjencitë dhe organizatat e përfaqësuara në Komitetin Drejtues të TALGA dhe agjenci dhe organizata partnere.
- j) Merr në dorëzim dhe administron dokumentat e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, të Komitetit Drejtues dhe të strukturave të tjera të TALGA-s.
- k) Merr pjesë në takime, borde apo agjenci dhe paraqet e mbron politikat dhe propozimet e miratuara nga organet drejtuese të TALGA-s.
- l) Kujdeset për menaxhimin dhe përditësimin e informacionit digjital në faqen e internetit dhe median sociale të TALGA-s, si dhe për botimet e saj.
- ll) Mundëson transparencën e veprimtarisë dhe dokumentacionit të TALGA-s, mbarëvajtjen e punës dhe aktivitetëve të saj dhe promovon TALGA-n në ngjarje dhe veprimtari të mbajtura brënda dhe jashtë Shqipërisë.
- m) Kujdeset për mirëmenaxhimin e pasurive të TALGA-s.
- n) Nënshkruan, në emër të TALGA-s marrëveshje me palët e tjera.
- nj) Përfaqëson TALGA-n në aktivitete të organizuara nga të tretët, ku TALGA është e ftuar.

KREU III

FINANCIMI

Neni 12

Burimet financiare

1. Burimet financiare të TALGA-s janë:

- a) Pagesa e kuotës monetare së anëtarësisë;
 - b) Pagesat nga shërbimet për të tretët
 - c) Fonde, grante dhe dhurime të dhëna nga subjekte shtetërore, private dhe publike, vendase dhe të huaja;
 - ç) Të ardhura të tjera të ligjshme nga veprimtari ekonomike, pasuritë në pronësi të TALGA-s, apo tjetër, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, të cilat përdoren vetëm për mbështetje dhe përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të veprimtarisë së TALGA-s.
2. TALGA ka buxhetin e vet, i cili hartohet, miratohet dhe zbatohet në përputhje me këtë Statuti, rregulloret dhe aktet e miratuara nga organet e TALGA-s, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
3. Të ardhurat, fondet dhe pasuritë e TALGA-s nuk mund të përdoren përveçse në interes dhe në mbështetje të misionit, qëllimeve dhe veprimtarisë së TALGA-s dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e TALGA-s prej personave që janë subjekte të këtij Statuti ose aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave,

pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të TALGA-s.

Neni 13

Auditimi i TALGA-s

1. TALGA dhe pasqyrat e saj financiare auditohet çdo vit nga një kompani auditimi e licensuar nga institucionet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe sipas legjislacionit në fuqi në fushën e auditimit.
2. Raporti i auditimit paraqitet dhe shqyrtohet nga Këshilli Drejtues dhe nga Asambleja e Përgjithshme e TALGA-s dhe bëhet publik në faqen e internetit të TALGA-s.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Transparanca e veprimtarisë së TALGA-s

1. TALGA garanton për anëtarët e saj dhe për publikun transparencën e veprimtarisë së saj.
2. Aktet e organeve të TALGA-s publikohet në faqen zyrtare të internetit të TALGA në përputhje me këtë Statut, vendimet e Asamblesë dhe Komitetit Drejtues të TALGA-s, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 15

Shpërndarja e TALGA-s

TALGA shpërndahet në këto raste:

- a) Kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar nga Kodi Civil në fuqi;
- b) Kur qëllimi i TALGA-s është përmbushur ose nuk ka më mundësi të përmbushet;
- c) Me vendim të Gjykatës përkatëse të Republikës të Shqipërisë, kur TALGA është larguar nga qëllimi i shprehur në këtë Statut ose kur ajo ka filluar të kryejë veprimtari të kundraligjshme;
- ç) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, i cili merret me votën “Pro” të 2/3 të numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të saj, por në çdo rast me votimin “Pro” të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore.
- d) Në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

Likuidimi i TALGA-s

1. Pas miratimit të vendimit për shpërndarjen e TALGA-s, Asambleja e Përgjithshme emëron likuidatorin nga lista e likuidatorëve të përcaktuar në Gjykatën përkatëse të Republikës të Shqipërisë.

2. Pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve dhe borxheve të TALGA-s, fondet dhe pasuria i mbesin themeluesve të TALGA-s. Nëse ndonjë nga themeluesit ka pushuar së ekzistuari, fondet dhe pasuria i kalojnë anëtarëve që në momentin e shpërndarjes kanë statusin e themeluesit ose kanë zëvendësuar ndonjë nga themeluesit.
3. Asambleja e Përgjithshme vendos për ndarjen e fondeve dhe pasurive të mbetura mes themeluesve apo për qëllime në interes të themeluesve.
4. Asambleja e Përgjithshme miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga Gjykata përkatëse e Republikës së Shqipërisë ç'regjistrimin e TALGA-s

Neni 17

Ndryshimet e statutit të TALGA-s

1. Ndryshimet në këtë Statut bëhen me vendim të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe me miratimin me votën "Pro" të jo më pak se 2/3 të numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme, dhe në çdo rast me votën "Pro" të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore.
2. Vendimi për ndryshimet në statut i paraqitet Gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së vendimit.

Neni 18

Ndjekja e procedurave të rregjistrimit

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet vendore të paraqesë përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kërkesën dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për njohjen dhe regjistrimin e TALGA-s si person juridik.
2. Personi i caktuar në pikën 1 autorizohet:
 - Të nënshkruaj kërkesën e Shoqatës për regjistrimin e saj për t'u depozituar pranë Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse;
 - Të ndjekë procedurat përkatëse dhe të nevojshme për regjistrimin dhe depozitimin në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe të gjithë autoriteteve të tjera, të aktit të themelimit dhe të statutit, dhe të dokumenteve të tjera përkatëse për regjistrimin e Shoqatës;
 - Të kryejë të gjitha veprimet e tjera dhe të lëshojë të gjitha deklaratat e nevojshme apo të dobishme lidhur me veprimet e sipërpërmendura.

ANËTARËT THEMELUES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

MARRËVESHJE

PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TE SHQIPËRISË, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA).

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë ____ / ____ /2025 ndërmjet:

Ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”*,

Dhe,

Bashkisë Korçë , përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z.Sotirag Filo

Bashkisë _____, përfaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./znj. _____

Bashkisë _____, përfaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./znj. _____

Bashkisë _____, përfaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./znj. _____

Bashkisë _____, përfaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./znj. _____

Bashkisë _____, përfaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./znj. _____

Këshillit të Qarkut _____, përfaqësuar nga Kryetari z./znj. _____

Këshillit të Qarkut _____, përfaqësuar nga Kryetari z./znj. _____

Këshillit të Qarkut _____, përfaqësuar nga Kryetari z./znj. _____

(në vijim, referuar së bashku si “Palët”)

- Duke qenë se vetëqeverisja vendore në Shqipëri përballlet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të burimeve, në hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve dhe komuniteteve vendore, si dhe në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët;
- Duke njohur se procesi i decentralizimit të funksioneve drejt bashkive, si dhe rritja e kërkesave nga komunitetet vendore për shërbime më efikase, e bëjnë të domosdoshëm përditësimin, përmirësimin dhe avancimin e njohurive dhe aftësive të të zgjedhurve vendorë dhe punonjësve të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Duke theksuar se njësitë e vetëqeverisjes vendore janë aktorë thelbësorë në zbatimin e reformave strukturore në kuadër të integritit evropian të vendit, përfshirë reformën në administratën publike;
- Duke qenë të vetëdijshëm se përmbushja e objektivave të vetëqeverisjes vendore dhe rritja e cilësisë së shërbimeve publike në nivel vendor kërkojnë rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të burimeve njerëzore të njësive të vetëqeverisjes vendore;

Palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje sipas kushteve dhe përcaktimeve të mëposhtme:

Neni 1 **Baza ligjore**

1. Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me:

- a) Nenit 2, pika 1, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja “h”, nenit 77 shkronja “ç”), “d”, “gj”, nenit 78 pika 1, nenit 83 shkronja “d”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- b) Nenet 24–26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
- c) Ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar;
- d) Ligjin nr. 80, datë 24.6.2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”;
- e) Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- f) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.07.2025, “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”;
- g) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.04.2023, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030”.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i një personi juridik, subjekt i kompetencave të përbashkëta, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, bashkive dhe qarqeve, të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e miratuara nga këshillat e bashkive dhe nga këshillat të qarqeve përkatëse për themelimin e këtij subjekti sipas statutit, me synim rritjen dhe forcimin e vazhdueshëm dhe cilësor të kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë, nëpunësve civilë dhe punonjësve të institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV)

Neni 3

Forma dhe emri i subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP)

1. Palët bien dakord që personi juridik, subjekt i kompetencave të përbashkëta, të krijohet në formën e organizatës jo fitimprurëse, sipas dispozitave të ligjit nr.8788/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve” të ndryshuar, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Emri i OJF-së do të jetë “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” (në vijim: **TALGA**¹), e cila do të veprojë në përputhje me statutin e saj të miratuar nga palët themeluese të TALGA .

Neni 4

Autorizimi për përfaqësim dhe nënshkrim të akteve themeluese të TALGA

Autorizohen përkatësisht kryetari i bashkisë dhe kryetari i këshillit të qarkut që të përfaqësojnë njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse në të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për nënshkrimin dhe depozitimin e aktit të themelimit dhe statutit të subjektit “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” (TALGA), në përputhje me vendimet e miratuara nga këshillat përkatës të bashkive dhe këshillat të qarqeve dhe me këtë marrëveshje.

Neni 5

Objekti i subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP)

Palët bien dakord që objekti i veprimtarisë së SKP-së do të jetë mbështetja dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore të njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë shërbimesh, përfshirë por pa u kufizuar në:

- vlerësimin e nevojave për trajnim, hartimin e programeve të trajnimit dhe planeve të trajnimeve,
- hartimin e kurrikulave dhe ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme e të specializuara,
- administrimin e platformës për menaxhimin dhe ndarjen e njohurive,

¹¹ Akronimi “TALGA” rrjedh nga emërtimi në gjuhën angleze *Training Academy of Local Government in Albania* dhe përdoret si formë identifikuese institucionale, e përzgjedhur nga palët dhe e cituar në Statutin e TALGA.

- rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me çdo NJVV brenda dhe jashtë vendi, si dhe me institucione qëndrore dhe vendore vendase dhe të huaja,
- ofrimin i ekspertizës dhe shërbimeve të konsulencës ndaj NJVV-ve,
- bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj,
- kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.
- çdo veprimtari tjetër që nuk bie ndesh me qëllimin e kësaj marrëveshjeje dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Palët bien dakord, që personi juridik OJF “Akademia për Trajnimin e Njësive të Qeverisjes Vendore ” (TALGA), të krijohet për një afat të pacaktuar si dhe në përputhje me Statutin e saj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Kontributi financiar i palëve

Palët bien dakord që kontributi financiar të ndahet si më poshtë:

1. Këshilli i Ministrave do të financojë kostot fillestare të themelimit të subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” (TALGA), dhe të jo më pak se 50% të kostove vjetore operative dhe të trajnimeve për tri vitet e para të funksionimit të TALGA me qëllim përmbushjen e misionit dhe objektivave të saj, në përputhje me **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.07.2025**, *“Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”*.
2. Ndihmesa financiare e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, parashikohet në buxhetin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV).
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) do të financojnë jo më pak se 50% të kostove vjetore operative dhe të trajnimeve për tri vitet e para të funksionimit të TALGA, me qëllim përmbushjen e misionit dhe objektivave të saj. Kontributi financiar i çdo NJVV-je, për buxhetin TALGA, do të parashikohet në buxhetet e tyre vjetore dhe afatmesme, dhe do të përlllogaritet bazuar në kuotën vjetore për çdo NJVV, të miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të TALGA.

4. Pas përfundimit të periudhës fillestare 3-vjeçare, përqindja e kontributit të mëtejshëm financiar të palëve, Këshillit të Ministrave dhe NJVV-ve, do të përcaktohet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave dhe vendimin të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA dhe në përputhje me planin financiar afatmesëm të TALGA, të miratuar sipas dispozitave të statutit dhe rregulloreve të TALGA.
5. Palët, sipas legjislacionit në fuqi dhe nevojave të TALGA, mund të ofrojnë ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar, ndihmesë me dhenjen në huapërdorje të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, etj.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që lind midis palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet në radhë të parë nëpërmjet dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.
2. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet në këtë mënyrë, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 9

Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga të gjitha palët dhe pas verifikimit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut përkatës, në përputhje me:
 - a) pikën 5 dhe pikën 6 të nenit 14 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar;
 - b) dhe nenin 7 të ligjit nr. 107/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 36/2024, "Për prefektin e qarkut", i cili përcakton procedurën dhe kompetencën e prefektit për verifikimin e akteve me karakter normativ dhe efekte financiare të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
2. Nëse Prefekti nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar me ligj për verifikimin e ligjshmërisë, akti konsiderohet i konfirmuar në heshtje dhe marrëveshja hyn automatikisht në fuqi.

Nënshkruesit:

Ministrit përgjegjës për çështjet vendore, z./znj. _____;

Kryetari i Bashkisë Korçë, z. Sotiraq Filo

Kryetari i Bashkisë _____, z./znj. _____

Kryetari i Bashkisë _____, z./znj. _____

Kryetari i Bashkisë _____, z./znj. _____

Kryetari i Këshillit të Qarkut _____, z./znj. _____

Kryetari i Këshillit të Qarkut _____, z./znj. _____

Kryetari i Këshillit të Qarkut _____, z./znj. _____